

RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS

RAPORTI VJETOR 2009

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Raporti i Programit dhe Aktiviteteve 2009

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
+381 (0) 38 245 850
Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
info@womensnetwork.org
www.womensnetwork.org

MISIONI I RRJETIT TË GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS (RRGGK)

RrGGK përkrah, mbrohet dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga qëndrimi politik, religjioni, mosha, niveli i arsimimit, orientimi seksual apo aftësitë tjera. RrGGK përmbush misionin e saj përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, avokimeve dhe hulumtimeve.

PËRMBAJTJA

Objektivat e RrGGK-së	2
Lidhur me këtë Raport	3
Pjesëmarrja e Barabartë Efektive dhe Aktive e Grave dhe Vajzave në Zhvillimin Politik, Ekonomik dhe Social të Kosovës	4
Përmirësimi i të Drejtave Njerëzore të Grave në të gjitha Sferat e Jetës në Kosovë	9
Përmirësimi dhe ngritja e Bashkëpunimit mes Grupeve dhe Organizatave të Grave në Kosovë, Rajon dhe Botë	12
Bordi i Drejtorëve i RrGGK-së	21
Anëtarët e Stafit të RrGGK-së	22
Raporti i Auditit 2009	23
Raporti Financiar 2009 i RrGGK-së	24
Plani i Punës për vitin 2010	26
Organizatat Anëtare të RrGGK-së	28

OBJEKTIVAT E RRGK

- I.** Të sigurojë pjesëmarrje të barabartë, efektive dhe aktive të grave dhe vajzave në zhvillimin politik, ekonomik dhe social të Kosovës;
- II.** Të përmirësojë të drejtat njerëzore të grave në të gjitha sferat e jetës në Kosovë; dhe
- III.** Të përmirësojë dhe ngrisë nivelin e bashkëpunimit mes grupeve dhe organizatave të grave në Kosovë, rajon dhe kontekst ndërkombëtar.

LIDHUR ME KËTË RAPORT

Raporti mbulon periudhën e aktiviteteve gjatë vitit 2009. Si gjithmonë raporti ynë vjetor shërben për të informuar anëtarët, partnerët dhe miqtë e RrGGK-së për aktivitetet dhe të arriturat e shënuara gjatë vitit.

Raporti gjithashtu përmban pasqyrat financiare të RrGGK-së si dhe auditin për vitin 2009. Ky aport është i ndarë bazuar në programet sipas strategjisë së RrGGK-së si vijon:

- Pjesëmarrja e barabartë efektive dhe aktive e grave dhe vajzave në zhvillimin politik, ekonomik dhe social të Kosovës;
- Përmirësimi i të drejtave njerëzore të grave në të gjitha sferat e jetës në Kosovë; dhe
- Përmirësimi dhe ngritja e bashkëpunimit mes grupeve dhe organizatave të grave në Kosovë, rajon dhe botë.

PJESËMARRJA E BARABARTË EFEKTIVE DHE AKTIVE E GRAVE DHE VAJZAVE NË ZHVILLIMIN POLITIK, EKONOMIK DHE SOCIAL TË KOSOVËS

RrGGK ishte pjesëmarrëse në seminarin ndërkombëtar mbi fuqizimin e grave

Më 7 dhe 8 mars, anëtarja e bordit të RrGGK-së dhe drejtoresha ekzekutive e Qendrës për Trajnime dhe Studime Gjinore (QTSGJ), Arjeta Rexhaj, mori pjesë në Seminarin Ndërkombëtar mbi Fuqizimin e Grave, Zhvillimin e Lidershit, Paqen dhe Sigurinë Ndërkombëtare në Monrovia, Liberi, të udhëhequr nga presidentet Ellen Johnson Sirleaf e Liberisë dhe Tarja Halonen e Finlandës. Seminari mbledhi së bashku qindra aktiviste dhe zyrtarë qeveritarë nga tërë bota për të diskutuar për fuqizimin e grave në arenat politike, ekonomike dhe sociale. Aktivistet u mbledhën për të ndarë përvojat e tyre dhe për të mësuar nga ato të tjerëve mbi temat si roli i grave në lidership, dhunën në baza gjinore, zbatimin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB-së 1325, qëllimi #3 për Zhvillim të Mileniumit mbi promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, efekti i krizës ekonomike globale mbi gratë, statusi seksual dhe riprodhues i grave, ndërrimet klimatike dhe migrimi. Pika kulmore e ngjarjes ishte miratimi i Deklaratës së Monrovia më 8 mars, Dita Ndërkombëtare e Grave e emëruar nga Kombet e Bashkuara. Seminari gjithashtu themeloi një mekanizëm për qëndrueshmërinë e punës së saj me krijimin e Qendrës Ndërkombëtare Angie Brooks mbi Fuqizimin e Grave, Zhvillimin e Lidershit, Paqen dhe Sigurinë Ndërkombëtare.

“Zëri i votuesve” vazhdoi të bëjë të dëgjueshme brengat e qytetarëve

Më 17 Prill në Hotel Grand, RrGGK bëri publikimin e raportit të fundit të projektit “Zëri i Votuesve”. Në praninë e gazetarëve, hapjen e kësaj ngjarjeje e bëri Ambasadori i Zyrës së Mbretërisë së Bashkuar, i cili falënderoi dhe uroi RrGGK-në për punën e bërë.

Nga të dhënat e dala nga ky raport, ndër shqetësimet më kryesore të qytetarëve të Kosovës me të drejtë vote ishin: reduktimet e ujit, reduktimet e rrymës, rrugët e pa asfaltuara, korrupsioni, papunësia, varfëria, sisteme jo adekuate të ujësjellësve, shërbimet jo cilësore shëndetësore si dhe ndotja e ambientit. Në raport janë përfshirë 1052 thirrje në linjën telefonike, e cila është pa pagesë në shërbim të qytetarëve (0800 201 401), gjithashtu janë përfshirë ankesat e pranuar në e-mail adresën zerivotuesve@gmail.com si dhe nga takimet e mbajtura në tetë komuna

të Kosovës. Nga takimet me qytetarë, në secilën prej tyre ishin prezent mbi 50 pjesëmarrës, që numëron mbi 400 qytetarë në të tetë komunat.

Raporti përfshin ankesat e qytetarëve nga 28 komuna, prej 35 sa ka gjithsejtë Kosova. Ankesat janë ndarë sipas komunave, dhe për secilën komunë janë parashtruar rekomandime varësisht prej nevojave të qytetarëve të asaj komune. Raporti u është dorëzuar të gjithë deputetëve të Parlamentit, udhëheqësve të ministrive, kryeministrit, kryetarëve të komunave si dhe ambasadave dhe zyrave ndërlidhëse në Kosovë.

Me 24 gusht, në Hotel Grand në Prishtinë, pas një konference për media, filloi nënshkrimi i petitionit: “S’ka ujë, s’ka vota”. Në linjat pa pagesë janë pranuar më shumë se 1600 thirrje. Mungesa e ujit të pijshëm si dhe sistemet e dobëta të ujërave të zeza ishin ndër ankesat kryesore të qytetarëve. Me moton “S’ka UJË, S’ka VOTA”, qytetarët kërkuar nga institucionet përgjegjëse realizimin e premtimeve të bëra në zgjedhjet e kaluara sa i përket mungesës së ujit.

Duke parë që gjendja e ujit është duke u përkeqësuar çdo ditë e më shumë, RrGGK në bashkëpunim me disa organizata, iniciuan nënshkrimin e petitionit nga qytetarët, petition ky që përmban dy kërkesa: ujë të pijshëm 24 orë, si dhe përmirësim të sistemeve të ujërave të zeza.

Bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, peticioni ka filluar në disa komuna, aty ku problemi me ujë të pijshëm është më i theksuar. Të ndihmuar nga aktivistë të Kryqit të Kuq të Kosovës si dhe organizata dhe individ të ndryshëm, peticioni vazhdoi deri në fund të muajit shtator. Pas mbledhjes së nënshkrimeve, ato u dorëzuan në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë.

Me 3 nëntor, koordinatoresha e projektit “Zëri i Votuesve”, u takua me përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Prezent në këtë takim ishin këshilltarët politik të Ministrit Mahir Yagcilar, z. Husnia Beshkoviç, z. Hazir Cadraku, znj. Gynaj Hallaq, znj. Ermira Bojku si dhe drejtori i Ujësjellësit Regjional Batllava z. Skender Bubaku.

Pas prezantimit të petitionit, i cili ka grumbulluar gjithsejtë 2829



nënshkrime, përfaqësuesit e MMPH-së paraqitën problemet që ata hasin në punën e tyre, për të përmirësuar gjendjen e ujit të pijshëm dhe të sistemeve në ujësjellës. Mungesa e fondeve ishte njëra prej pengesave që pamundëson përmirësimin e këtij problemi. Gjithashtu, pati dhe premtime se gjendja e ujit të pijes do të rregullohet, duke thënë se ky problem është edhe prioritet i kësaj ministrie, mirëpo një gjë e tillë është e pamundur të ndodhë në një të ardhme të afërt. Që qytetarët e Kosovës të kenë ujë të pijshëm në dispozicion 24 orë, do të duhen së paku edhe 5 vite punë, kanë thënë përfaqësuesit e kësaj ministrie.

Ministrisë gjithashtu i është bashkangjitur edhe një letër rekomandimi me mundësitë se si do të mund të rregullohet problemi i ujit të pijshëm. Ndër këto rekomandime hyjnë:

- gjobot të cilat duhet të paguhen nga personat të cilët e keqpërdorin ujin, shpenzojnë ujin e pijshëm,
- hedhin mbeturina apo bëjnë derdhjen e kanalizimeve në ujëra që përdoren për pije;
- të krijohet Eko-Fondi nga gjobot e lartpërmendura,
- angazhim më i madh i inspektorëve si dhe monitorim i punës se tyre;
- të njoftohen qytetarët për masat që do të ndërmerren në rast të keqpërdorimit të ujit të pijshëm (nëpërmjet mediave elektronike dhe të shkruara).

“Zëri i Votuesve” ka filluar funksionimin në shtator të vitit 2008 dhe njëherësh ka dëshmuar gatishmërinë për të dërguar kërkesat e qytetarëve në adresë të duhur.

RrGGK ka publikuar botimin e dytë të “Raport për Monitorimin e Zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë”

Me 12 qershor, RrGGK ka publikuar botimin e dytë të “Raport për Monitorimin e Zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë”. Raporti fokusohet në çështjet e grave, paqes dhe sigurisë që nga publikimi i botimit të parë në vitin 2007.

Botimi i dytë i këtij raporti ofron një analizë gjithëpërfshirëse të implementimit të Rezolutës 1325 dhe është i ndarë në dy pjesë gjithëpërfshirëse. Pjesa e parë e raportit ofron një përmbledhje të institucioneve në Kosovë të cilat duhet të zbatojnë implementimin e rezolutës. Këtu përfshihen organizatat ndërkombëtare siç janë Forca e Kosovës e NATO-së (KFOR), Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), Policia Civile Ndërkombëtare (CIVPOL), Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), dhe Agjencitë e Kombeve të Bashkuara, si ajo për Zhvillim (UNDP), për Gra (UNIFEM), për Fëmijë (UNICEF) dhe Refugjat (UNHCR). Gjithashtu diskutohet për institucionet lokale, përfshirë qeverinë e Kosovës, Kuvendin e Kosovës,

Agjencionin për Barazi Gjinore (ABGj), Policinë e Kosovës, sistemin juridik dhe kodin penal në Kosovë, si dhe shoqërinë civile të Kosovës.

Pjesa e dytë e raportit ofron një analizë kritike për progresin e implementimit të tri fushave kyçe të Rezolutës 1325 në Kosovë. Ato janë: përfshirja e grave në të gjitha proceset vendimmarrëse, përfshirja e perspektivës gjinore në procedurat trajnuese për policinë dhe njësitë ushtarake, dhe mbrojtja e të drejtave njerëzore të grave në fushat e arsimimit, ekonomisë dhe lirisë nga dhuna. Gjithashtu adresohet mbrojtja e të drejtave të anëtareve gra të grupeve minoritare të Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve në Kosovë.

Hartimi dhe publikimi i botimit të dytë të “Raportit për Monitorimin e Zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë” si dhe gjetjet adekuate flasin për rëndësinë e vazhdueshme për avokim për përfshirjen e zërave të grave në arenën e paqes dhe sigurisë.

Për versionin elektronik të këtij raporti, ju lutemi klikoni në faqen e internetit të RrGGK-së: www.womensnetwork.org.

RrGGK mori pjesë në konferencën kombëtare të grave në Shqipëri

Me 28 Tetor, organizata “Refleksione” organizoi në Tiranë konferencën njëditore me temën “Fuqizimi i grave në Shqipëri- strategji për zhvillim gjithëpërfshirës”, me përkrahje të USAID.

Pas përshëndetjes nga Presidenti Bamir Topi, gratë në politikë dhe shoqëria civile diskutuan temat: barazia gjinore në kuadrin e integritetit të Shqipërisë në BE dhe Legjislacioni për barazinë gjinore.

Gjatë pjesës së parë u shfaqën dy filma dokumentar “Me vrapin e mendjes” dhe “Në kërkim të pafundësisë”. Në pjesën e dytë u organizuan punëtoritë me temat: Prioritetet për fuqizimin ekonomik të grave, për zgjerimin e mundësive në arsimim, për përmirësim të shërbimeve shëndetësore dhe modelet e suksesshme për ndërhyrje strategjike në nivel të komunitetit. Në këtë të fundit, Igballe Rogova dha shembuj të suksesshëm nga aktivitetet që ka zhvilluar shoqata “Motrat Qiriazit” dhe për aktivitetet nga periudha e pasluftës nga RrGGK.



RrGGK mori pjesë në prezantimin e studimit 'Kosova pas pavarësisë'

Me 27 nëntor, drejtoresha ekzekutive e RrGGK, Igballe Rogova, mori pjesë në prezantimin e Studimit dhe Diskutimin mbi "Kosova pas Luftës - A ka arritur misioni i BE-së përmes EULEX-it të përbush misionin e saj ashtu siç është premtuar", të mbajtur në Vjenë të Austrisë. I organizuar nga Renner-Institute, qëllimi i këtij prezantimi është që të bëjë një analizë mbi misionin e EULEX-it në Kosovë. Në Dhjetor 2009 bëhet një vit prej kur Misioni i EULEX-it në Kosovë zyrtarisht ka filluar punën e tij. Deri më tani të dhënat mbi këtë mision jashtëzakonisht të shtrenjtë, janë më se dëshpëruese-suksesi i pritur mbi promovimin e sundimit të ligjit ka dështuar, Veriu i Kosovës ende kontrollohet nga Beogradi. Legjitimiteti i "status-neutral" i misionit të BE-së është i ulët në të dyja anët, Serbët dhe Shqiptarët e Kosovës- gjë që mund të dëshmohej në bazë të analizave të bëra ku del se 90 % e popullatës së Kosovës nuk pajtohet me praninë e misionit të EULEX-it dhe politikave të BE-së në Kosovë. Strategjia e përgjithshme e misionit të BE-së në Kosovë nuk dallon shumë nga ajo e UNMIK-ut. Brukseli ende nuk ka dalur me ndonjë strategji të qartë mbi procesin e ndërhyrjes së EULEX-it në Kosovë.

Përveç Igballe Rogovës në këtë prezantim morën pjesë: Vedran Dzihic dhe Helmut Kramer, që të dy profesorë në Universitetin e Vjenës si dhe bashkautorë të këtij raporti, Ulrike Lunacek- deputete e parlamentit të BE-së raportuese për Kosovën, Dominique Orsini - Shef i Njesisë për politika në EULEX; Albert Rohan ish-zëvendës i të dërguarit të posaçëm për Kosovën, si dhe Hannes Söboda- Deputet-Zëvendëskryetar i grupit Socialist, Anëtar i Delegacionit të BE-së në Kosovë. Për çasje në prezantimin e plotë të këtij studimi mund të klikoni në vegzën:

<http://library.fes.de/pdf-files/id/ipa/06571.pdf>



PËRMIRËSIMI I TË DREJTAVE NJERËZORE TË GRAVE NË TË GJITHA SFERAT E JETËS NË KOSOVË

RrGGK dhe Rrjeti Rinor i Kosovës (RrRK) dënuan dhunën në familje

Më 20 dhjetor 2008, me moton "Gratë dhe burrat kundër Dhunës në Familje", RrGGK dhe RrRK, organizuan protestë kundër dhunës në familje.

Bazuar në të dhënat e Policisë së Kosovës vetëm gjatë vitit 2008 në Kosovë 8 persona janë vrarë nga anëtarët e familjeve të tyre, 5 raste tentim vrasje dhe shumë persona kanë vuajtur dhe janë lënduar nga anëtarët e familjeve të tyre, të dhëna këto mjaft shqetësuese.

RrGGK është kontaktuar nga qytetarë të shqetësuar, burra dhe gra, për të organizuar një protestë të tillë, dhe për ta ngritur zërin publikisht për rastet e dhunës në familje.

"Në emër të këtyre qytetarëve të shqetësuar, në emër të viktimave të dhunës, ne ju ftojmë që të bëjmë thirrje tek strukturat udhëheqëse të shtetit, të ndjekin penalisht kryerësit e këtyre veprave në kohë të duhur dhe në pajtueshmëri me ligjin. Ne ftojmë të gjitha institucionet të përfshihen në këtë proces dhe të angazhojnë qoftë burime financiare apo edhe ato njerëzore për të parandaluar dhunën, për të mbrojtur viktimat dhe për të ndjekur penalisht autorët e krimit si dhe tu shqiptohen dënimet ashtu si i parashohin ligjet në fuqi. Është koha që së bashku t'i themi Stop Dhunës në Familje, të Kërkojmë Drejtësi dhe të Kërkojmë Siguri." u shpreh Igballe Rogova gjatë protestës.

Protesta u mbajt në të njëjtën orë edhe në katër qendra tjera të Kosovës: në Prizren, Gjakovë, Gjilan dhe Pejë.



RrGGK publikoi raportin mbi përgjigjen e akterëve të drejtësisë ndaj dhunës në familje në Kosovë

Nga qershori deri në shtator të vitit 2009, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), me mbështetje financiare nga Iniciativa për Siguri dhe Mbrojtjen e Grave (ISMG) e UNDP-së dhe me mbështetje nga Agjencia për Barazi Gjinore në zyrën e Kryeministrit të Kosovës (ABGj), zhvilloi një hulumtim si reagim ndaj ofruesve të drejtësisë ndaj Dhunës në Shtëpi.

Hulumtimi kishte për qëllim të "mbështes qeverinë e Kosovës dhe ligjvënësit drejt përgatitjes dhe zbatimit të Planit për Veprim Kombëtar kundër Dhunës në Shtëpi (PVK-DS) dhe Ligjit kundër Dhunës në Shtëpi (LDS)", ku që të dyja ishin në proces të draftimit. Qëllimi i hulumtimit ishte të krijohej një "kuptueshmëri gjithëpërfshirëse e sistemit të drejtësisë në Kosovë që i përket zbatimit të legjislacionit mbi dhunën në shtëpi".

Më 22 shtator 2009 në Villa Gërmia në Prishtinë, më shumë se shtatëdhjetë persona morën pjesë në punëtorinë mbi "Qasjen në Drejtësi për Viktimat e Dhunës në Shtëpi". Në mesin e pjesëmarrësve ishin zyrtarë nga Qendra për Punë Sociale, Strehimore, Gjykata Komunale, Gjykata Rajonale, Policia e Kosovës, Departamenti për Avokim dhe Asistencë ndaj Viktimave, Ministria e Punëve të Brendshme, e të tjerë. Pjesëmarrësit ishin të ndarë në tri grupe pune në mënyrë që ta rishikojnë draft-raportin e parë, "Reagimi i Ofruesve të Drejtësisë ndaj Dhunës në Shtëpi në Kosovë", dhe të ofrojnë rekomandime. Grupet ishin: 1. Mbrojtja ndaj Dhunës në Shtëpi, 2. Policia e Kosovës, dhe 3. Mbrojtja e të drejtave dhe qasjes së viktimave. Në këtë raport gjithashtu u përfshinë rekomandimet e bëra nga grupi punues.

Me 23 nëntor, në Ndërtesën e Qeverisë, u publikua raporti "'Më Shumë se Fjalë në Letër?' Përgjigja e Organeve të Drejtësisë Ndaj Dhunës në Familje". Duke u bazuar në intervista me më shumë se 60 përfaqësues të institucioneve, 96 viktima të dhunës në familje dhe hulumtimet e mëhershme, ky raport identifikon çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij. Të gjeturat dhe rekomandimet të cilat rezultojnë nga to kanë për qëllim t'i kontribuojnë hartimit të Ligjit të ri për mbrojtje kundër dhunës në familje, Strategjisë kombëtare dhe Planit të veprimit kundër dhunës në familje edhe legjislacionit tjetër i cili qeverisë ndjekjen penale të krimeve të kryera në marrëdhëniet familjare, procedurat operative dhe punën e institucioneve përgjegjëse për sigurimin e qasjes në drejtësi.

Raporti vlerëson performacën e gjyqtarëve në ofrimin e mbrojtjes kundër dhunës në familje përmes mekanizmave siç janë urdhrat për mbrojtje; ndjekja penale e akteve të dhunës në familje; hetimin e akteve të dhunës në familje



nga Policia e Kosovës, si dhe veprimeve për të mbrojtur viktimat nga dhuna e mëtejshme; puna e institucioneve dhe organizatave të ndryshme përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të viktimave gjatë qasjes së tyre në drejtësi; dhe perceptimet e qytetarëve për sistemin gjyqësor, që mund të ndikojnë në vendimet e tyre për të kërkuar drejtësi apo për të heshtur. Raporti përfundon me rekomandime për hartuesit e politikave dhe institucionet individuale drejt rritjes së qasjes në drejtësi për viktimat e dhunës në familje.

Raporti është në dispozicionin tuaj në faqen e internetit të UNDP-së (www.ks.undp.org), të RrGGK-së (<http://www.womensnetwork.org>), dhe Qeverisë së Kosovës (<http://www.ks-gov.net/portal/eng.htm>).

RrGGK përkrahu marshin kundër kancerit të gjirit dhe organizatën Jeta Vita

Me 24 tetor, Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit (QKLKGJ) Jeta Vita, në partneritet me organizata tjera në Kosovë, organizoi fushatë për ngritjen e vetëdijes lidhur me kancerin e gjirit gjatë Muajit Ndërkombëtar për Luftimin e Kancerit të Gjirit. RrGGK përkrahu këto përpjekje duke shpërndarë informatat lidhur me këtë marsh dhe shfaqjen me shtatë monologje të grave që kanë përjetuar kancerin e gjirit.

RrGGK filloi fushatën për vetëdijesimin e mekanizmave për Barazinë Gjinore

Me përkrahjen e UNIFEM-it, RrGGK filloi fushatën për vetëdijesimin e mekanizmave për barazinë gjinore në Kosovë. Në tremujorin e fundit të vitit, u organizuan tubime me gra në 12 komuna, ku përafërsisht u tubuan mbi 350 gra. Në këto tubime pos mekanizmave vendore si ligji për Barazi Gjinore, gratë u njoftuan edhe me mekanizmat ndërkombëtare si p.sh, konventa CEDAW dhe Rezoluta e Kombeve të Bashkuara 1325. Fushata do të vazhdojë nëpër komunat tjera edhe gjatë vitit 2010.



PËRMIRËSIMI DHE NGRITJA E BASHKËPUNIMIT MES GRUPEVE DHE ORGANIZATAVE TË GRAVE NË KOSOVË, RAJON DHE BOTË

Gratë aktiviste nga Liberia, Afganistani dhe Republika Demokratike e Kongos vizituan Kosovën

Në kuadër të projektit "Ndërtimi i Paqes" i implementuar nga organizata themeluese "Medica Mondiale" me seli në Gjermani, "Medica Kosova" ka organizuar takimin njëjavor të projekteve simotra nga Liberia, Afganistani, dhe Republika Demokratike e Kongos.

Gjatë vizitës një-javore në Kosovë, përfaqësueset e këtyre vendeve së bashku me koleget nga Gjermania dhe përfaqësuesja e ISIS Europe (International Security Information Service) kanë realizuar një takim pune njëditor me Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës në Prishtinë të përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive, znj. Igballe Rogova dhe Kryetarja e Bordit, znj. Beti Muharremi.

Takimi kishte për qëllim njohjen me aktivistet e të drejtave të grave nga Afrika dhe Afganistani si dhe bartja e përvojës së RrGGK-së për themelimin dhe funksionimin e rrjetit në kohën e pas-luftës dhe përfshirja e të gjitha grupeve etnike në realizimin e aktiviteteve si rrjet.



Mesazhi i Drejtoreshës së RrGGK-së drejtuar mysafireve nga Afrika dhe Afganistani kishte të bënte me forcën dhe vullnetin e grave për të ndërtuar rrjete të fuqishme duke mos lejuar ndërhyrjet politike të donatorëve dhe jashtë kufijve etnik dhe religjioz. Raporti i znj. Rogova ka ofruar një shembull të një praktike më të mirë të punës së rrjetit në realizimin e fushatave dhe aktiviteteve avokuese, shembull ky që u mirëprit nga përfaqësueset e Liberisë, RD të Kongos dhe Afganistanit. Pjesëmarrëset e këtij takimi u inspiruan dhe inkurajuan nga përvojat e RrGGK-së, sidomos nga fillimi i themelimit dhe sfidat e shumta gjatë punës së rrjetit.

U themelua rrjeti SAVE (Sisters Against Violent Extremism)

Gratë pa kufij (Women Without Borders nga Vjena) ishin nikoqire të Konferencës së parë ndërkombëtare të Sisters Against Violent Extremism (SAVE) në Vjenë. Pasi që gratë shpesh janë lënë jashtë proceseve vendimmarrëse sa i përket terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, pjesëmarrëset kërkonin të hulumtojnë dhe sajojnë 'vizione alternative të luftimit të terrorizmit'.

Tridhjetë e tri gra nga të gjitha anët e botës, jetët e të cilave janë prekur në ndonjë mënyrë nga terrorizmi apo ekstremizmi i dhunshëm morën pjesë në këtë konferencë. Ato këmbyen përvojat e tyre dhe shpresat e zbatimit të strategjive inovative për t'iu kundërvënë terrorizmit. Mes pjesëmarrësve ishte Drejtoresha Ekzekutive e RrGGK-së Igballe Rogova.

Për më shumë informata mbi SAVE dhe aktivistet tjera në këtë rrjet, vizitoni: <http://www.women-without-borders.org/save/network/>.



Koalicioni i Grave për Paqe (KGP) shqyrtoi bashkëpunimin në të kaluarën dhe bashkëpunimin aktual

Më 15 dhjetor, përfaqësues të Koalicioni i Grave për Paqe (KGP) u takuan në Prishtinë për të shqyrtuar sukseset dhe sfidat e koalicionit gjatë dy viteve të fundit.

Si suksese u theksuan dy konferencat e organizuara nga KGP në Strugë të Maqedonisë, ku morën pjesë përfaqësues nga Serbia, Bosnjë e Hercegovina, Maqedonia dhe Kosova. Konferencat paraqitnin një vend të sigurt ku gratë ndanin kujtimet e tyre mbi luftën, si parakusht për zhvillimin e mirëfilltë të proceseve të shërimit dhe ardhmërisë në paqe.

Gjatë konferencës së dytë, përfaqësueset e Grave në të Zeza për herë të parë publikisht kërkuar falje për krimet e kryera ndaj shqiptarëve të Kosovës gjatë luftës. Përmes një fjalimi emocional, ato kërkuar falje për vuajtjet që në emër të tyre forcat serbe u sollën shqiptarëve. Kërkimfalja u emitua në televizionet kombëtare në Kosovë dhe paraqiti një hap të rëndësishëm të procesit të pajtimit.

Konferencat gjithashtu sollën në të njëjtën tavolinë për herë të parë përfaqësues të organizatave të grave nga Kosova dhe Serbia, nga zona tjera dhe jo vetëm nga kryeqytetet e tyre Prishtina e Beogradi. Kjo i hapi rrugë bashkëpunimit dhe këmbimit të informatave mes grave me prapavija të ndryshme. RTV 21 bëri produksionin e një filmi dokumentar mbi koalicionin dhe punën e tij, i cili u emitua në Kosovë dhe në konferenca të ndryshme anembanë botës. Filmi dëshmon bashkëpunimin aktual me qëllim të arritjes së paqes mes Serbëve dhe Kosovarëve.

Mes suksesesh, koalicioni gjithashtu është përballë me sfida të shumta. Gratë kosovare nuk janë lejuar të kalojnë kufirin për të marrë pjesë në takimet e KPG-së në Beograd për shkak se Qeveria e Serbisë refuzon të njohë dokumentet e udhëtimit të UNMIK-ut. Si rezultat e kësaj, gratë serbe gjithnjë udhetojnë në Prishtinë ku mbahen takimet. Pamundësia për të udhëtuar ka bërë që shpresat e përfaqësuesve të KGP-së për rrjetëzim horizontal ndërkuftar të jenë të vështira për tu realizuar.

Tensionet politike gjatë viteve 2007 dhe 2008 gjithashtu nënkuptonin që KGP nuk do të mund të realizojë karvanin e planifikuar të paqes. Ato shpresonin që karvani do të udhëtonte nëpër Kosovë, për të bërë më të dukshëm bashkëpunimin mes grave Kosovare dhe Serbe, dhe për të dhënë mesazhe paqeje.

Gjatë shtjellimit të së ardhmes së tyre, anëtarët e KGP-së u pajtuan se duhet të fokusohen në një nismë tjetër rajonale, Lobin Rajonal të Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi (LRG). Lobi përbëhet nga gra nga shoqëria civile dhe politika nga të gjitha vendet e Evropës Juglindore të përfshira në aktivitete politike. LRG dërgon deklarata dhe lobon tek vendimmarrësit ndërkombëtar lidhur me çështje që janë në interes të grave, paqes dhe sigurisë në Evropën

Juglindore. OJQ-të e grave të përfshira në KPG do të vazhdojnë të organizojnë aktivitete të përbashkëta ndërkufitare dhe të komunikojnë haptas mes veti.

Ideja e krijimit të KGP erdhi kur përfaqësuesit e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) i vizituan Gratë në të Zeza në Beograd në vitin 2006. Duke krijuar këtë koalicion, gratë shqiptare dhe serbe shpresojnë të fuqizohen më tej dhe të përfshijnë më shumë organizata në bashkëpunimet aktuale mes grave në Evropën Juglindore. Koalicioni pati një rol aktiv të rëndësishëm, duke bërë kështu të dëgjohet zëri i gruas gjatë negociatave për statusin final të Kosovës.

Gratë aktiviste nga Izraeli vizituan Kosovën

Nga 11 - 16 tetor, me përkrahjen e organizatës suedeze, Kvinna till Kvinna, RrGGK ishte nikoqire e një delegacioni të organizatave të grave nga Izraeli dhe Palestina. Ato së pari kaluan disa ditë në Serbi dhe pastaj erdhën në Kosovë së bashku me Rrjetin e Grave në të Zeza. Qëllimi i vizitës së tyre ishte që të shkëmbejnë përvoja me organizatat e grave në Ballkan.

Ky delegacion vizitoi organizatat e grave në Prishtinë si: Dera e Hapur dhe Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Në Gjilan vizituan Qendrën "Liria" ndërsa në Gjakovë, organizata Medica ishte nikoqire e këtij delegacioni. Poashtu ato u njoftuan edhe me aktivitetet e organizuara në Mitrovicë gjatë vizitës në CBM (Community Building Center) dhe në Ugljare patën rastin të njoftohen me aktivitetet e organizuara nga rrjeti i organizatave serbe të Kosovës.



Rrjeti i Grave në të Zeza publikuan librin me rrëfime të grave

Me 12 tetor në Hotel Prishtina u bë publikimi i librit "Ana Femërore e Luftës", organizuar nga Kvinna till Kvinna dhe RrGGK.

Libri është botim i Grave në të Zeza nga Serbia dhe përmban rrëfimet e grave dhe përvojën e tyre gjatë luftës në

Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi.

Në mesin e miqve dhe partnerëve lokal e ndërkombëtar ishin edhe aktivistet nga Izraeli, organizatat e grave hebreje dhe palestineze të cilat pas vizitës në Serbi po qëndronin në Kosovë.

RrGGK mbajti mbledhjen e shtatë vjetore

Më 12 dhjetor, RrGGK mbajti mbledhjen e saj të anëtarësisë, ku morën pjesë anëtarët, stafi dhe përkrahësit e saj. Belgjyzare Muharremi, kryetare e Bordit të RrGGK-së, hapi takimin duke përmendur disa nga të arriturat kryesore të RrGGK-së.

Drejtoresha ekzekutive e RrGGK-së, Igballe Rogova, duke shprehur falënderimet për ndihmën dhe mbështetjen, prezantoi punën e RrGGK-së nga dhjetori 2008 deri në dhjetorin e 2009-ës. Edhe gjatë këtij viti RrGGK realizoi misionin e saj duke vazhduar të ndërtojë kapacitetet si rrjet; mori pjesë në takime lokale, rajonale dhe ndërkombëtare; bashkëpunoi me qeverinë dhe avokoi tek ta; dhe bashkëpunoi për së afërmi me organizata ndërkombëtare. Gjate kuvendit u aprovia edhe strategjia e Rrgk per vitin 2010.

Meqë shumica e pjesëmarrëseve ishin anëtarët, gjatë mbledhjes u diskutua shumë edhe për bashkëpunimet dhe mënyrën e ndihmës që mund ti ofrohet njëra tjetrës si OJQ në realizimin sa më efikas të programeve të përbashkëta. Anëtarët e RrGGK gjithashtu kanë plotësuar pyetësorin vlerësues për punën e RrGGK gjatë vitit 2009 dhe pas analizës së këtij vlerësimi del se kërkesa më e shpeshtë është gjetja e donatorëve.

Për dallim nga vitet e kaluara, RrGGK kësaj radhe nuk e bëri lojën e fatit, mirëpo u ofroi anëtareve materiale për zyre.

Mbledhjet e Bordit të RrGGK-së

Gjatë vitit 2009, Bordi i Drejtorëve i RrGGK-së është takuar në mars, shtator dhe dhjetor. Përveç këtyre takimeve ata kanë qenë gjithmonë të informuar për aktivitetet e Rrjetit, duke qenë kështu në kontakt të rregullt përmes email-it dhe telefonit si dhe për të kërkuar këshilla, sipas nevojës.

Anëtarët e RrGGK-së

RrGGK ka vazhduar me takimet e rregullta me anëtarët e saj. Këto takime ofruan mundësin e një forumi për anëtarët për pranimin e informatave të reja mbi programet e RrGGK-së, për këmbim të informatave dhe përvojave, si

dhe për inicim të aktiviteteve të përbashkëta. Takimet u mbajtën më:

2 shkurt, 6 prill, 12 qershor, 28 shtator dhe 9 nëntor. Kuvendi Vjetor i RrGGK-se është mbajtur me 12 Dhjetor 2009.

RrGGK është munduar që të ofrojë sa më shumë shërbime për anëtarët e saj. Edhe këtë vit organizatat anëtare kanë kërkuar informata, mbështetje teknike, asistencë në hartim të propozimeve, lidhjes së organizatave me donatorë, negocimit me donatorë në emër të anëtarëve, ndihmë në përkthime, etj., dhe ne kemi bërë përpjekje shtesë për të shpërndarë informata këtë vit përmes email-it dhe telefonit. Për shembull, RrGGK ka përcjellë informata mbi mundësitë e ndryshme të financimit për anëtarët (p.sh., thirrjet për propozime) dhe ka ndarë informata te anëtarët mbi ngjarje të ndryshme që cilat kanë ndodhë në vend dhe rajon.

RrGGK vazhdoi Buletinin në tri gjuhë

RrGGK vazhdoi me publikimin e buletinit "Zëri i Gruas Kosovare". Tri botime të buletinitin tremujor të RrGGK-së kishin informata mbi RrGGK-në dhe aktivitetet e anëtarëve të saj. Buletini është shpërndarë edhe në formë elektronike edhe në kopje fizike në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

RrGGK ka ofruar informata edhe përmes faqes së internetit dhe komunikimeve me email me hulumtuesit, shkrimtarët dhe aktivistet e saj, kudo në botë.

RrGGK po ashtu ka informuar mediat vazhdimisht për aktivitetet që ka ndërmarr.

RrGGK vazhdoi monitorimin e Kodit të Mirësjelljes

Edhe gjatë vitit 2009 përfaqësues të RrGGK-së u takuan me organizatat anëtare të saj për të plotësuar aplikacionin, pas korrigjimeve në Kodin e mirësjelljes së RrGGK-së, bazuar në komentet e anëtarëve. Në mungesë të disa aplikacioneve që akoma nuk janë plotësuar nga anëtarët, RrGGK ka shtyrë afatin e përpilimit të profileve e organizatave anëtare, që do të postohen në faqen e internetit të RrGGK-së dhe do të publikohen në një pamflet mbi anëtarët.

Studentët e huaj vizituan RrGGK-në

Më 15 janar 2009, studentët nga European Inter-University Centre për të Drejtat e Njeriut dhe Demokratizimin, i themeluar në Venedik vizituan RrGGK. Tashmë tradicionale, ky universitet, në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës, dërgon çdo vit nga një grup të studentëve për vizitë studimore. Në agjendën e tyre as sivjet nuk mungoi takimi me RrGGK-në. Ata patën rastin të njoftohen për historikun e RrGGK-së si dhe shumëçka rreth rolit të grave

në Kosovë para, gjatë dhe pas luftës. Studentët gjithashtu u shprehën që ky ishte takimi më informues dhe më i këndshëm gjatë gjithë vizitës së tyre në Kosovë.

Me 17 shkurt, edhe një grup tjetër i studentëve nga Universiteti Buffalo, vizituan RrGGK. Edhe ky grup ishte më i interesuar të mësonte më shumë rreth rolit të gruas kosovare në politikë dhe vendimmarrje si dhe rolin e organizatave të grave në Kosovë.



RrGGK ndihmoi në themelimin e Rrjetit të organizatave të grave serbe të Kosovës

Aktivistët për të drejta të grave serbe në Kosovë kanë ardhur në përfundim se puna e OJQ-ve serbe ka dështuar që të përfshijë zërat e grave dhe vajzave nga rrethet serbe që mendojnë se integrimi dhe një jetë më e mirë në Kosovë është domosdoshmëri. Ato kanë konkluduar se gratë nga komuniteti serb i takojnë një grupi mjaft sensitiv dhe nën-shtrohen në luajtjen e një roli shumë pasiv në procesin e tranzicionit dhe demokratizimit.

Në pajtim me përvojën e tyre, dhe me qëllim të tërheqjes së përfshirjes së tyre në zhvillimet e përgjithshme të realitetit të ri në Kosovë, pesëmbëdhjetë OJQ janë bërë bashkë për të krijuar një rrjet të përbashkët, në partneritet dhe bashkëpunim me UNIFEM-in. Si rezultat i bashkëpunimit të gjatë në mes të OJQ-ve serbe, është themeluar Rrjeti i organizatave të Grave Serbe të Kosovës si pjesë përbërëse e Rrjetit të Grupeve të Grave në Kosovë.

Gjatë majit, Rrjeti i organizatave të Grave Serbe të Kosovës ka filluar procesin e regjistrimit, ka përgatitur të gjitha dokumentet e nevojshme, dhe është marrë vesh mbi strukturën funksionuese të rrjetit dhe misionin, vizionin dhe caqet strategjike të tij për vitin 2009.

Misioni i Rrjetit të organizatave të Grave Serbe të Kosovës është që të rrisë vetëdijen mbi të drejtat e grave, të fillojë aplikimin e plotë të rregullimeve ligjore që mbrojnë të drejtat e grave, përhapin kulturën e paqes, tolerancës, dialogut, bashkëpunimit dhe marrëveshjes në zgjedhjen e problemeve me të cilat ballafaqohet. Rrjeti do të fillojë punën duke forcuar kapacitetet organizuese dhe duke krijuar mekanizmat e një rrjeti funksional.


Rrjeti i grave nga Shqipëria viziton RrGGK

Në tetor, një grup i organizatave të grave nga Shqipëria vizituan Kosovën. Rrjeti i Grave të Shqipërisë (RrGSh), rrjet ky i sapo formuar në Shqipëri vizituan RrGGK dhe disa prej organizatave anëtare të saj. Qëllimi i vizitës ishte ndarja e përvojës se si RrGGK është themeluar dhe si ka vazhduar deri në krijimin e një rrjeti udhëheqës në rajon me 87 organizata anëtare.

Drejtoresha e RrGGK nderohet në San Francisko

Në korrik 2009, në San Francisco në Ndërtesën e Grave (The Women's Building), e emëruar nga Marta Drury dhe Kerry Lobel, është shtuar emri Igo Rogova në muralin e të famshmëve botërorë të veprave madhështore. Ajo tani është pjesë e këtij kontributi të veçantë dhe jetëgjatë për shumë femra të veçanta nga e gjithë bota. Emri i saj u shtua në muralin e bukur gjatë verës së 2009-ës dhe gjithnjë do të jetë pjesë e 'Ndërtesës së Grave' (The Women's Building).

Mbi 200 femra janë nderuar në shtesën e re të Muralit të më të Famshmëve Botëror të Veprave Madhështore. Gjithashtu, në këtë mural mund të gjeni emrat e famshëm, si: Nënë Tereza, Angela Davis, Mother Jones, Queen Califa, Joan of Arc, Alice Walker, Emma Goldman, Ella Fitzgerald, Eleanor Roosevelt, Aung San Suu Kyi, etj. Vepra madhështore është sa edukative aq edhe frymëzuese dhe shërben si testament vizuel për kontributet e guximshme të grave nëpër kohë dhe nëpër të gjithë botën. Për më shumë informata rreth këtij murali mund të vizitoni: www.womensbuilding.org.



Gratë Parlamentare nderojnë aktivistet dhe organizatat e grave

Në dhjetor, Grupi Joformal i Grave Deputete të Kuvendit të Kosovës, mbështetur nga OSBE-ja dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), organizoi një ceremoni në shenjë mirënjohjeje për gratë që dhanë kontribute të veçanta në avancimin e pozitës së gruas në shoqërinë kosovare.

Në fjalën hyrëse të kësaj ceremonie të ndarjes së mirënjohjeve për gratë më të suksesshme të vitit 2009, Flora Brovina theksoi se “Grupi Joformal i Grave Deputete përbëhet nga 37 deputete të të gjitha nacionaliteteve. Ky grup ka arritur të ndërtojë dialogun ndërpartiak e ndërnacional, me qëllim të realizimit të fuqizimit të gruas në politikë dhe vendimmarrje”. Sipas saj “lista e grave që merituan mirënjohje ishte shumë e gjatë, por asnjëra prej tyre nuk u harrua”.

Listën e grave dhe institucioneve që morën këto mirënjohje e bëri Bordi i Grave Deputete, ndërsa kjo nismë për ndarjen e mirënjohjeve planifikohet të jetë tradicionale.

Këtë ceremoni e përshëndeti edhe kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i cili njëherësh falënderoi Grupin e Grave Deputete për këtë nismë për të vlerësuar punën e grave.

Mirënjohje dhe falënderime për vitin 2009 iu takuan gjithsej 16 grave dhe institucioneve të ndryshme të Kosovës dhe institucioneve ndërkombëtare, përkatësisht: Leze Qenës - aktore, Igballe Rogovës – drejtore ekzekutive RrGGK, Majlinda Kelmendit - bartëse e çmimit botëror për mundje, Afërdita Saraçinit - drejtoreshë e RTV 21, Linda Shalës - afariste,OJQ-ve “Medica Kosova”, “Norma”, “Jeta”, “Dera e hapur”, “Të vejave të Krushës”, “Jeta –Vita”, si dhe Milka Koliqit dhe Myzefa Terziqit. Ndërsa, falënderime iu takuan OSBE-së dhe NDI-së.

BORDI I RRGK GJATË VITIT 2009 - 2010

Belgjyzare Muharremi - Kryetare e Bordit - (Drejtoreshë – ‘Dera e Hapur’)

Arjeta Rexhaj (Drejtoreshë – ‘Qendra për Trajnime dhe Hulumtime Gjinore’)

Ariana Qosaj – Mustafa (Eksperte Ligjore / Aktiviste për të drejtat e grave

Behar Selimi (Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës)

Nazlie Bala (Aktiviste për të drejtat e grave)

Shukrije Gashi (Drejtoreshë – ‘Partners Kosova’)

Veprorë Shehu (Drejtoreshë – ‘Medica Kosova’)

Bordi Këshillëdhënës i RrGGK-së:

Besim M. Kajtazi (Drejtor i Zyrës Ligjore – Qeveria e Kosovës)

Delina Fico (Aktiviste për të drejtat e grave)

Marte Prenkpalaj (Koordinatorë ‘Motrat Qiriazit’)

Rachel Wareham (Këshilltare e pavarur / Aktiviste)

Vjosa Dobruna (Aktiviste për të drejtat e njeriut)

STAFI I RRGK GJATË VITIT 2009

Igballe Rogova
Drejtoreshë Ekzekutive

Besa Shehu
Menaxhere për Financa

Alba Loxha
Menaxhere për Informim dhe Qasje

Nicole Farnsworth
Këshilltare dhe Hulumtuese

Adelina Berisha
Koordinatorë e projektit 'Zëri i Votuesve'

Mimoza Gashi
Hulumtuese

Adem Gashi
Hulumtues

Dafina Beqiri
Koordinatorë e projektit 'Kodi i Mirësjelljes së RrGGK-së'

Tiffany Ommundsen
Praktikante nga 'Projekti për Avokim' (qershor-gusht)

RAPORTI VJETOR I AUDITIT TË RRGK-SË

RRIJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS (RRGGK)

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: MENAXHMENTIN EKZIKUTIV TË RRIJETIT TË GRAVE TË KOSOVËS (RRGGK) PRISHTINË

Ne kemi audituar kostot financiare dhe të dhënat plotësuese të Rrijetit të Grave të Kosovës (RrGGK) të shprehura në F-1/R, për periudhën janar-dhjetor 2009. Këto pasqyra financiare dhe të dhënat plotësuese financiare janë përgjegjësi e menaxhmentit të projekteve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një mendim mbi informatat e lartpërmendura financiare bazuar në auditimin tonë.

Ne kemi kryer auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA). Këto standarde kërkojnë që të planifikojmë dhe ta zbatojmë auditimin për të marrë një siguri të arsyeshme se a i përmbajnë formularët për raportim deklaratat e gabuara. Një auditim përshin ekzaminimin, në bazë të një prove, dëshni që mbështet shumat dhe zbulimet në formularët për raportimin. Një auditim gjithashtu përshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e duhur të kontabilitetit dhe raportimin e të dhënave në pasqyrat financiare. Ne besojmë se auditimi i ynë, ofron një bazë të arsyeshme.

Sipas mendimit tonë, të dhënat financiare, në mënyrë të drejtë i paraqesin të gjitha aspektet materiale, si dhe shpenzimet e Rrijetit të Grave të Kosovës që nga 31 Dhjetori 2009, dhe rezultatet e operacioneve, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet të Kontabilitetit të Kosovës.

Xhemail Syla
Auditor i licencuar
"Syle Hotia" #1
Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +377 44 156 921
Faks: +381 38 551 790


XHEMAIL SYLA
Auditor i licencuar
044/156 921, Prishtinë
Dje 2010-10-14

Prishtinë
26 Mars 2010

RAPORTI FINANCIAR I RRGK-SË PËR VITIN 2009

Donatorët	Projektet	Të bartura nga v.2008	Të pranuarë 2009	Shpenzimet 2009	Të bartura në 2010
1 UNDEF ('07 - '09)	Rrjetëzimi i Grave për Paqe dhe Stabilitet Rajonal	15,077.58	0.00	15,077.58	-
2 Ambasada Britanike	Iniciativa Qytetare për Qeverisje të mirë	10,348.00	14,333.45	24,681.45	-
3 UNIFEM Kosova	Ngritja e Vetëdijes mbi Mekanizmat Gjykor në Kosovë		7,350.00	4,871.83	2,478.17
4 UNDP / WSSI	Hulumtim për Përgjigjen e Drejtësisë lidhur me Dhunën në Familje		20,780.00	20,780.00	-
5 Fondacioni MOTT	Përkrahje Institucionale për RrGGK	500	15,236.44	15,309.09	427.35
6 Kvinna till Kvinna	Fuqizimi i Kapaciteteve të RrGGK për Avokim	700	32,047.00	32,147.00	600
7 BTD	Iniciativa Qytetare për Qeverisje të mirë		31,730.00	13,938.60	17,791.40
8 UNIFEM Austria	Qasja e Grave në Përkujdesjen Shëndetësore (projek i Medica Kosovë)		10,000.00	10,000.00	-
9 Ambasada e SHBASë	Përkrahje për Serial Televiziv		14,970.00	14,970.00	-
Totali		26,625.58	146,446.89	151,775.55	21,296.92

KOSTOT OPERATIVE DHE PROGRAMATIKE TË RRGK-SË



PLANI I PUNËS PËR VITIN 2010

Objektivat	Programet	Aktivitetet
1. Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë, efektive dhe aktive të grave dhe vajzave në zhvillimet politike, ekonomike dhe shoqërore në Kosovë.	1.1. Fuqizimi i grave në politikë dhe vendimmarrje.	Raport përmbledhës 10 vjeçar mbi monitorimin e Rezolutës 1325 në Kosovë dhe kontributi për përpilimin e planit të veprimit të Rezolutës 1325. Fushatë vetëdijesimi lidhur me mekanizmat për barazi gjinore në Kosovë. Avokim për përfshirje të gruas në Sektorin e Sigurisë (Këshillin për Siguri, Forca të Sigurisë dhe Agjencionin për Inteligjencë). Takime me gratë votuese në Kosovë. Vazhdimi i linjës telefonike dhe përgatitja e raporteve.
2. Përmirësimi i të drejtave njerëzore të grave në të gjitha sferat e jetës në Kosovë	2.1. Përmirësimi i shëndetit të grave	Përkrahja e fushatave kundër kancerit të gjirit. Kontributi në përgatitjen e strategjisë kundër kancerit të gjirit. Raport vlerësimi mbi kapacitetet e sistemit të shëndetësisë publike lidhur me shëndetin e grave.

Objektivat	Programet	Aktivitetet
	2.2. Ulja e trafikimit / dhunës në familje	Vazhdimi i përkrahjes për Koalicionin Kosovar kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës Seksuale. Fushatë vetëdijesimi mbi ligjin dhe strategjinë kundër dhunës në familje
3. Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së grupeve dhe organizatave të grave në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare si dhe në angazhimet avokuese gjegjëse	3.1. Rritja e përfshirjes së grave në ndërtimin e paqes në rajon 3.2. Fuqizimi i kapaciteteve të Rrjetit	Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi me organizatat e grave të rajonit. Përkrahje për fuqizimin e organizatave të grave serbe në Kosovë. Buletini tremujor. Raporti Vjetor. Monitorimi i implementimit të Kodit mbi Etikën dhe Përgjegjësitë. Përgatitja e një broshure me profilet e organizatave anëtare të Rrjetit. Mirëmbajtja e faqes së Internetit të RrGGK-së në tri gjuhë dhe paraqitja në këtë faqe e profileve të organizatave. Shërbime për organizatat anëtare të Rrjetit: përkrahja në ngritjen e fondeve, përkthime, trajnime. Organizimi i mbledhjeve dymujore të rrjetit.

ANËTARET E RRGK-SË GJATË VITIT 2009

Ajo

Maria Kurti
044 286 319
ugaafrodita@hotmail.com
Ferizaj

Alma

Shemsije Seferi
044 257 443
shemsijeseferi@hotmail.com
Sverkë, Pejë

Antigona

Rabe Rustemi
044 192 232
r_rustemi@hotmail.com
Skenderaj

Asebe

Esma Karanezi
044 128 126
Prizren

Ato

Fikrije Ferizi
044 332 558
qendraegruas_ato@hotmail.com
Vushtrri

Aureola

Saniye Grajçevci
044 502 578
aureola_p95@hotmail.com
Prishtinë

Bardha

Raza Sadrija
044 104 126
Prishtinë

Briga

Miroslavka Simonovic
063 7210 616
miroslavkabriga@yahoo.com
Gorazdevac

Centari Romani Gjuvlenge

Emsale Mergjollari
044 274 671
emsalemergjollari@hotmail.com
Prizren

Dera e Hapur

Belxhyzare Muharremi
044 124 423
betimuharremi@hotmail.com
Prishtinë

Diana

Silvana Vokshi
044 769 778
Gjakovë

Dora Dorës

Vjosa Curri
044 216 616
dora_dores@yahoo.com
Prishtinë

Dora e Ngrohtë

Drita Rama
044 264 102
drita.g.rama@gmail.com
Rahovec

Drita

Fexhrie Mavriqi
044 649 168
febimav@yahoo.com
Prishtinë

Dua

Ilirjana Kryeziu
044 309 439
ojqduaaa@yahoo.com
Prizren

Edona

Hafize Hajdini
044 657 920
ngoedona@yahoo.com
Ferizaj

Elena Gjika

Lale Grabanica
044 199 167
grabanica@hotmail.com
Klinë

Familja dhe Shpresa

Atifete Bytyqi
044 329 196
atifetebytyqi@hotmail.com
Klinë

Femra në Veprim

Kadrije Berisha
044 227 820
kpiliqi@yahoo.com
Kaçanik

Flaka

Shehindere Dedushi
044 195 940
delidedushi@hotmail.com
Lipjan

Foleja

Gjyzel Shaljani
044 219 612
gjyzelshaljani@gmail.com
Prizren

Fortesa

Saniye Jahiri
044 643 665
saniye200@hotmail.com
Kamenicë

Gruaja Familjare

Nadire Kryeziu
044 217 223
gruaja_familjare@hotmail.com
Prizren

Gruaja për Gruan

Shemsije Xhaferi
044 155 286
xhaferi_shemsije@hotmail.com
Rahovec

Grupi i Veteranëve të Arsimit

Naxhije Buçinca
044 233 633
naxhi_gva@yahoo.com
Prishtinë

Hadër

Resmije Krasniqi
044 278 538
haderprizren@hotmail.com
Prizren

Handikos

Drita Vukshinaj
044 263 636
handikos_pz@hotmail.com
Prizren

Handikos

Mehreme Llumnica
044 198 688
mehremellumnica@hotmail.com
Prishtinë

Hanëmeli

Lirije Gash
044 343 709
liriyegas@hotmail.com
Prishtinë

Hareja

Sahadete Dula
044 204 321
shpg.hareja@hotmail.com
Prizren

Idemo Pravo

Zhivadinka Radosavlevic
064 447 0 967
Plemetin

Indira

Lize Marku
044 963 727
l_marku@hotmail.com
Videjë/Klinë

Institute of Psychology

Myrvete Bajrami
044 209 017
mbajrami@gmail.com
Prishtinë

Jeta

Safete Gacaferri
044 253 412
ojqjeta@yahoo.com
Deçan

Jeta Ime

Shqipe Bejtullahu
044 188 336
mylife_center@yahoo.com
Gjakovë

Jeto Jetën

Xhylnaze Bytyqi
044 187 021
jetojeten@hotmail.com
Prizren

Kalabria

Sevdie Bunjaku
044 234 190
kalabria24@hotmail.com
Prishtinë

Kevser

Igballe Berisha - Huduti
044 142 038
kewther_pz@yahoo.com
Prizren

Komitet Zena za Zastitu i Ljudska Prava

Snezana Karadzic
044 929 676
snezana.karadzic@gmail.com
Caglavica

Komiteti i Grave të Verbëra

Bajramshahe Jetullahu
044 185 298
kgvk_b@hotmail.com
Prishtinë

Kreativa

Klara Baraku – Idrizi
044 145 744
shoqata_kreativa@hotmail.com
Prishtinë

Legjenda

Melihate Osmani
044 194 045
meliosmani@yahoo.com
Viti

Lepsa Buducnost

Radosava Mirkovic
064 533 7885
lepsi.buducnost@yahoo.com
Priluzje

Lira

Valire Buza
044 189 775
valirebuza@hotmail.com
Prishtinë

Liria

Nazife Jonuzi
044 125 729
liriagjilan@hotmail.com
Gjilan

Liria

Luljeta Kuqi
044 186 824
luljeta_kuqi@hotmail.com
Suharekë

Lulebora

Selvete Gashi
044 110 970
ojqlulebora@yahoo.com
Prishtinë

Lulishtja

Sadije Dulahu
044 374 412
sadiesdulahu@hotmail.com
Dabishevc

Luna

Stanica Kovacevic
044 738 590
Fushë Kosovë

Mental Disability Rights International

Zamira Hyseni
044 176 287
zhyseni@mdri.org
Prishtinë

Medica Kosova

Veporre Shehu
044 188 316
medicam_kosova@yahoo.com
Gjakovë

Motrat Qiriaz

Marte Prenkpalaj
044 113 258
motratqiriazhas@yahoo.com
Has / Prizren

Nardi

Violeta Shehu
044 450 184
nardi_99@hotmail.com
Prishtinë

Ne Jemi Pjesë e Botës

Atifete Demaj
044 239 814
njpb05@hotmail.com
Fushë Kosovë

Norma

Valbona Salihu
044 126 428
shoqatanorma@yahoo.com
Prishtinë

Oda

Violeta Selimi
044 318 982
vselimi.oda@gmail.com
Prishtinë

OGPK

Rudina Gerdec - Llapashtica
044 308 758
aibi@hotmail.com
Prishtinë

One to One Kosova

Merita Halitaj
044 172 644
onetoonekosove@hotmail.com
Prizren / Pejë

OPER

Nuriye Ferati - Haziri
044 257 316
nuriye.ngo.oper@hotmail.com
Prishtinë

Promocom

Blerta Nezaj
044 145 554
ngo_promocom@yahoo.com
Gjakovë

Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit Jeta/Vita

Nafije Latifi
044 145 530
jeta.vita@yahoo.com
Prishtinë

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës

Feride Rushtini
044 501 904
krct_org@yahoo.com
Prishtinë

Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Luljeta Vuniqi
044 116 898
qksgj_kgsc@yahoo.com
Prishtinë

Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve

Naime Sherifi
044 508 081
cpwcprishtina@yahoo.com
Prishtinë

Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore

Hamijet Dedolli
hamijet_dedolli@yahoo.com
Prishtinë

Qendra për Mirëqenien e Gruas

Ardita Bala
044 223 543
pejawwc@yahoo.com
Pejë

Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve

Nora Hoxha
044 126 588
qsgf_pz@hotmail.com
Prizren

Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore

Arjeta Rexha
044 124 612
qtsgj@yahoo.com
Prishtinë

Qendra Resurse e OJQ-ve

Esma Smajli
029 631 357
ngoprizren@yahoo.com
Prizren

Romane Romnja

Shpresa Agushi
044 211 905
agushishpresa@yahoo.com
Gjilan

Ruka + Ruci

Nevenka Rikallo
044 839 986
rikalonevenka@yahoo.com
Fushë Kosovë

Sara

Dashurie Sahiti
044 373 036
dashurijesahiti@yahoo.com
Dragash

SHE - ERA

Mirlinda Kusari
044 122 696
wsheera@gmail.com
Gjakovë

Shoqata e Amviseve të Kosovës

Gjylfidane Morina
044 394 226
danemorina@yahoo.com
Prishtinë

Shoqata Këshilluese Edukative "Ujesa"

Shukrije Bytyqi
044 382 331
shke_ujesa@yahoo.com
Malishevë

Shoqata për Edukimin dhe Përkujdesjen e Familjes

Bahrije Deva
044 152 051
shepfgjakova@yahoo.com
Gjakovë

Shpresa

Sabrije Kukaj
044 170 652
sabrijekukaj@hotmail.com
Drenas

Shpresa & Shtëpitë e Fëmijëve

Valbona Çitaku
044 200 353
sdsf_ks@yahoo.com
Prishtinë

Shtëpia e Sigurtë

Sakibe Doli - Dobruna
044 161 857
linjajuaj@yahoo.com
Gjakovë

Shtjefën Gjeçovi

Shpresa Siqeca
044 350 023
shpresasiqeca808@yahoo.com
Prizren

Sibora

Hyrmete Celina
044 247 240
sibora_pz@yahoo.com
Prizren

Teuta

Nexhmije Bytyqi
044 216 623
nexhmijeb@yahoo.com
Prizren

Venera

Miradije Gashi
044 223 418
ngo-venera@live.com
Pejë

Violete

Bedrije Shala
044 317 652
bedrije.shala@hotmail.com
Barilevë / Prishtinë

Vita - Jeta

Ajshe Nuhiu
044 277 421
ajshenuhiu@yahoo.com
Prishtinë

Zana

Tahire Gashi
044 406 812
shg_zana@hotmail.com
Klinë

Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës
Raporti Vjetor 2009

Përpiluar dhe dizajnuar nga
ALBA LOXHA

© 2009 Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8,
10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Lejohet e drejta për ribotim.